

# Eventi më i madh i të mësuarit në histori

Gjatë Javës së Edukimit në Shkenca Kompjuterike  
5-11 Dhjetor, 2022

# ORA E KODIT

**Ora e Kodit** është një lëvizje globale e cila i prezanton miiona nxënës rreth botës me fushën e shkencave kompjuterike, duke i inspiruar fëmijët të mësojnë më shumë, të thejnë stereotipe dhe duke i bere ata qe të ndihen të fuqishëm në atë qe e bëjnë.



ÇDOKUSH, KUDO, MUND TË  
MBAJ NJË ORË TË KODIT.  
BASHKANGJITUNI ME NE!

[HourOfCode.com](https://www.HourOfCode.com)

## Cka është ora e kodit?

### Një hyrje një orëshe në shkencat kompjuterike

Ora e kodit filloi si një sfidë kodimi e cila zgjatë një orë e cila ka për qëllim t'i sfidojë dhe të ju jap nxënësve një hyrje zbavitese në shkencat kompjuterike dhe kështu është bërë një event global i mësimit të shkencave kompjuterike, poashtu është bërë një festim dhe një event i cili ka për qëllim të shpërndaj mesazhin e mësimit në shkenca kompjuterike dhe rëndesinë qe e ka kjo fushë tek publiku i gjërë.

Aktivitetet e Code.org përfshijnë Minecraft, Star Wars, Frozen, Angry Birds dhe Plants vs Zombies.



### Një ngjarje globale vjetore

Ora e Kodit mbahet cdo vit gjatë Javës së Edukimit në Shkenca Kompjuterike, gjatë javës së parë të Dhjetorit. Ky event ka mbeshtetje të madhe dhe është një mundësi ideale për shkollat dhe komunitetet të vendosin vëmendjen në programet e shkencave kompjuterike duke zgjeruar mundësitë për të gjithë pjesëmarrësit.

## Pse shkencat kompjuterike?

### Shkencat kompjuterike janë thelbësore

Shkencat kompjuterike po ndryshojnë cdo industri në planet. Cdo nxënës në shekullin 21 duhet të ketë mundësinë të mësojë se si të krijoj teknologji. Konceptet e shkencave kompjuterike poashtu ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit tek nxënësit dhe zhvillojnë aftësitë e zgjidhjes së problemeve duke i përgaditur ata për karrierat e tyre të ardhshme.

### Mundësi ekonomike për të gjithë

Pozitat brenda fushës së shkencave kompjuterike janë ndër pozitat që paguhen më së miri, dhe tashmë ky është sektori më i madh në Shtetet e Bashkuara. Cdo femijë e meriton mundësinë që të ketë sukses.

### Nxënësve ju pelqen ora e kodit!

Pyetsorët më të fundit kanë treguar se ndër klasat më të pëlqyera të nxënësve është shkenca kompjuterike së bashku me lëndët e arteve dhe dizajnit.

## Përtej Ores se Kodit

### Mos u ndal me një orë!

Shtoni klasa të shkencave kompjuterike brenda planit tuaj mësimor ose regjistrohuni në punëtori të ndryshme të zhvillimit profesional. Bëni një ndryshim që zgjat në shkollën tuaj. Mësoni me shumë në [code.org/yourschool](https://www.code.org/yourschool).



## Ora e Kodit ka bërë hapa të mëdhenj drejt sjelles së shkencave kompjuterike për të gjithë të rinjtë!

Në eventin e parë të Orës së Kodit i cili u mbajt nëntë vite më parë ku më shumë vajza provuan për herë të parë të kodojnë sesa që kanë provuar në 70 vitet e fundit!


## Personat e famshëm, vizionarët e teknologjisë, edhe ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara Barack Obama mbështetën Orën e Kodit.

- Cdo dyqan i Apple ka mbajtur një Orë Kodimi
- Ora e Kodimit është paraqitur në Apple, Amazon, Google, YouTube, Yahoo!, Bing dhe ne faqen kryesore të Disney.
- Personat e famshëm si Ashton Kutcher, dhe Jessica Alba dhe liderët e teknologjisë Sheryl Sandberg, Bill Gates dhe Jack Dorsey kanë biseduar me klasa të ndryshme përmes video konferencave.
- Presidenti Obama ka shkruar rreshtin e tij të parë në kod në fillim të Orës së Kodit në vitin 2014, dhe kryeministri kanadez Justin Trudeau ka lansuar Orën e Kodit në vitin 2016.
- Nxënësit e Orës së Kodit kanë hapur NASDAQ në një event special në vitin 2015.
- Më shumë se 400 partner janë bashkuar për të mbështetur këtë kampanjë, duke përfshirë këtu bordin e kolegjit, Microsoftin, Infosys Fondacion USA, Google, Salesforce, BlackRock, Verizon, Disney, Teach for America, Khan Academy, DonorsChoose.org e shumë të tjerë.


## Së bashku mund ta zgjedhim boshllëkun e diversitetit në shkencat kompjuterike!

Vajzat që zgjedhin shkencën kompjuterike si lëndë në shkollë të mesme kanë dhjetë herë më shumë shanca që ta zgjedhin si drejtim studimesh në universitet, mirëpo nxënëset femra momentalisht përbejnë 30% të klasave të shkollave të mesme në shkencat kompjuterike, dhe këto statistika nuk ndryshojnë në fuqinë punëtore! Një Orë Kodi është një mënyrë shumë e mirë për të filluar me adresimin e mungësës së diversitetit dukë i prezentuar vajzat me shkencat kompjuterike dhe potencialin që ka kjo fushë!

Kurse të shkencave kompjuterike të shkollës së mesme



Të diplomuarit në shkencat kompjuterike



Fuqia punëtore softuerike



"I sfidoj vajzat në cdo shtet që të mësojnë një Orë Kodimi"

**Malala Yousafzai**

Fituesja e Qmimit Nobel për paqe

**Bashkoju lëvizjes  
5-11 Dhjetor, 2022!  
Fillo tek [hourofcode.com](https://hourofcode.com)**

Më shumë se  
**100 million**  
nxënës kanë  
provuar  
Orën e Kodit.

**50%**  
nxënës të  
gjinisë femërore.

Më shumë se  
**1.5**  
miliard  
orë të servuara.